

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5858  
E enjte, 22 gusht 2019  
çmimi 0.40 €

BE-ja shtyn  
zgjerimin e Ballkanit  
Perëndimor I FAQE 8

Prof. Dr.  
Blerim REKA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI ISTREFI

## Telekomi nuk është afër privatizimit

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se Telekomit nuk është afër procesit të privatizimit as në aspektin procedural e as në atë të gjendjes momentale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në situatën aktuale në të cilën ndodhet Telekomit është e pamundur të privatizohet. "Po flitet dhe po proklamohet një privatizim që askund afër nuk është as në procedura dhe as në situatën në të cilën ndodhet Telekomit i Kosovës", ka thënë Istrefi, duke shtuar se deklaratat e tilla për privatizim më shumë i ngjasojnë fushatës elektorale sesa që ka diçka konkrete. Istrefi ka thënë se në momentin që ka marrë postin e kryeshefit ka targetuar disa projekte që të ketë stabilitet Telekomit dhe, sipas tij, një ndër to ka qenë rishtrukturuimi. Ai ka thënë se janë duke punuar shumë që të krijojnë një qëndrueshmëri në Telekomit e Kosovës



## Sot pritet të shpërndahet legjislatura e VI-të e Kuvendit

Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot (e enjte) pritet të votojnë për shpërndarjen e legjislaturës së VI. Të gjitha partitë parlamentare janë zotuar publikisht se do të votojnë për shpërndarjen e kësaj legjislature. Për të qenë votimi i suksesshëm, duhet që për shpërndarjen e Kuvendit të votojnë së paku 2/3 e deputetëve apo 80 deputetë.



Sipas Kushtetutës, pas shpërndarjes së Kuvendit, brenda 45 ditësh, vendi duhet t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare

## Veseli: Milionat e konfiskuara nga pasuria e paligjshme do të investohen në vende të reja të punës



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### AKTUALE

**NAIT HASANI, AMBASADOR  
I KOSOVËS NË SHQIPËRI** F. 3

**EPIK-u TREGON SE ÇFARË  
PËRFITON KOSOVA NGA 90.5  
MILIONË EURO TË IPA-s** F. 6

**12 FAMILJE SKAMNORE NË  
SKENDERAJ BËHEN ME SHTËPI  
TË REJA** F. 8



### EKONOMI



**PËRFUNDON PROTESTA  
E PUNËTORËVE TË AEROPORTIT  
TË PRISHTINËS** F. 9

**HAPET FAZA E DYTË  
E PROGRAMIT  
TË VETËPUNËSIMIT** F. 9

### SPORT

**OSMANI HARRON HUMBJEN  
NGA 'NIKLI': DUAM  
PIKË NDAJ LLAPIT** F. 14

## Raportet me Kosovën, në fokus të takimeve të Vuçiçit në ShBA

**BEOGRAD, 21 GUSHT** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç tha se ka pasur një bisedë të gjatë, serioze dhe të përgjegjshme me zëvendës-ndihmës sekretarin amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, për raportet mes Prishtinës dhe Beogradit, dhe në përgjithësi marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Serbisë.

Vuçiç deklaroi se Kosova ishte gjithashtu temë mbizotëruese në bisedimet që ka pasur me

nënkryetarin e Këshillit Atlantik, Damon Wilson.

"Mbrojtja e interesave të popullit serb në Kosovë dhe ruajtja e interesave jetike kombëtare dhe shtetërore të Serbisë ishin thelbi i angazhimit tim në bisedën me Wilson", tha Vuçiç, ka njoftuar rre.

Vuçiç u takua të martën në mbrëmje në Nju Jork edhe me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo.

Ai tha se i ka kërkuar Pompeo

që Shtetet e Bashkuara të shtojnë presionin ndaj Kosovës, për të hequr tarifën ndaj mallrave serbe, në mënyrë që të vazhdojë dialogu ndërmjet të dyja vendeve.

Në anën tjetër, Departamenti i Shtetit, përmes një komunikate, njoftoi se sekretari Pompeo, ka kërkuar rinisjen e negociatave me Kosovën për një marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit të përqendruar në njohjen e ndërsjellë.



## Parlamenti rus akuzon ShBA-në për ndërhyrje politike

Parlamenti i Rusisë pretendon se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë pas mitingjeve masive të opozitës, sikurse kjo protestë e kohëve të fundit në Moskë, por ShBA-ja e ka hedhur poshtë një akuzë të tillë

**MOSKË, 21 GUSHT** - Politikanët rusë akuzuan Shtetet e Bashkuara se përpiqen të ndërhyjnë në zgjedhjet që do të zhvillohen në Moskë për këshillin e qytetit, duke ndihmuar në organizimin e mitingjeve masive. Por Shtetet e Bashkuara e kanë hedhur poshtë një akuzë të tillë. Këtë javë parlamenti rus ngriti një komision për të hetuar ndërhyrjet e huaja në zgjedhje.

Parlamenti rus pretendon se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë pas mitingjeve masive të opozitës, sikurse kjo protestë e kohëve të fundit në Moskë. Anëtarët e parlamentit, të cilët u kthyen nga pushimet për një seancë të jashtëzakonshme të hënën, akuzuan Perëndimin për mbështetje të demonstratave për të ndikuar në zgjedhjet e muajit shtator për këshillin e qytetit të Moskës, ka njoftuar

voa.

"Kjo është e papranueshme kur bëhet fjalë për një ndërhyrje kaq cinike nga vendet e huaja, kur në faqet e internetit të Departamentit amerikan të Shtetit dhe ambasadës si dhe në disa media në pronësi të shtetit, bëhet thirrje për të marrë pjesë në demonstrata pa leje", tha kryetari i Dumës ruse Vyacheslav Volodin.

Parlamenti rus ka ngritur tashmë një komision për të hetuar ndërhyrjen e pretenduar të vendeve të huaja.

Demonstratat në Moskë nisën në korrik nxitur nga një vendim i autoriteteve zgjedhore për të ndaluar disa kandidatë të opozitës që të konkurrojnë në zgjedhjet që zhvillohen në Moskë.

Sipas kryetarit të Partisë Komuniste ruse Genadi Zuganov protestuesit kanë marrë me miliona nga jashtë,



për t'i organizuar tubimet.

"Pashë në faqen e internetit të Ambasadës amerikane se si ishte orkestruar gjithçka këtu. Mbaj mend dhe pashë se si u orkestruan më parë, në Çekosllovakia, Rumania e Jugosllavi", thotë Genadi Zuganov, drejtues i Partisë Komuniste ruse.

Zyrtarët rusë kritikuan Ambasadën amerikane për publikimin e një harte në faqen e internetit në të cilën tregohet vendi i tubimit.

Diplomatët amerikanë thanë që postimi ishte pjesë e procedurës rutinë të ambasadës për t'i paralajmëruar qytetarët amerikanë për vendet ku siguria e tyre mund të jetë në rrezik.

Shtetet e Bashkuara e hodhën poshtë pretendimin e Moskës për ndërhyrje të huaja.

Akuza duket se është një pasqyrim i pretendimeve amerikane për ndërhyrje të Rusisë në zgjedhje, thonë disa vëzhgues.

"Këtu ka një element të imitimit

dhe kjo është tejet e përhapur në politikën ruse. Ne thjesht po i përgjigjemi asaj që të tjerët bëjnë: është justifikimi i përgjithshëm", thotë Sergey Parkhomenko, gazetar.

Enti rregullator i medias ruse Roskommnadzor i kërkoi kompanisë Google të filtrojë përmbajtjen në lidhje me tubimet, të ndalë dërgimin e njoftimeve për videot në YouTube, të ndalë transmetimin e drejtpërdrejtë të protestave si dhe rastet e ndalimit të demonstruesve.

## PD: Fundi i Ramës do të vijë nga Shkodra

**TIRANË, 21 GUSHT** - Partia Demokratike, dega Shkodër ka paralajmëruar kryeministrin Edi Rama se pavarësisht hakmarrjes që ka nisur kundër Shkodrës, fundi i tij dhe i klikës së tij politike do të vijë pikërisht nga Shkodra.

"Pas protestave në qytetin e Shkodrës, Edi Rama nuk nguron as këtë herë të shfaqë urrejtjen që ai ka për Shkodrën e qytetarët e saj.

Ministria e Financave dhe

Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit përmes degës në Shkodër ka bllokuar funksionimin normal të Bashkisë Shkodër, duke bllokuar kështu fondet për shërbime e investime.

E dimë mirë se sa Edi Rama e do qytetin e Shkodrës, prej faktit që ai prej 6 vitesh qeverisje, në qytetin tonë ka sjellë zëro investime e tani do të bllokojë edhe investimet që bashkia bën me të ardhurat e veta.

Edi Rama në mënyrë të drejtpërdrejtë po i bllokoi shërbimet qytetarëve të Shkodrës.

Qytetarët e Shkodrës nuk të kanë asnjë borxh. Ashtu si të gjithë qytetarët e Shqipërisë ato paguajnë taksat dhe për këtë meritojnë shërbimet për të cilat ato vetë po paguajnë.

Çfarëdo që të bësh, duhet ta dish mirë që fundi yt dhe i klikës tënde politike do të vijë nga Shkodra!", thuhet në deklaratën e PD-së.



Legjislatura e VI mban mbledhjen e fundit

# Sot pritet të shpërndahet legjislatura e VI-të e Kuvendit

Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot (e enjte) pritet të votojnë për shpërndarjen e legjislaturës së VI. Të gjitha partitë parlamentare janë zotuar publikisht se do të votojnë për shpërndarjen e kësaj legjislature. Për të qenë votimi i suksesshëm, duhet që për shpërndarjen e Kuvendit të votojnë së paku 2/3 e deputetëve apo 80 deputetë. Sipas Kushtetutës, pas shpërndarjes së Kuvendit, brenda 45 ditësh, vendi duhet t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme parlamentare

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

**PRISHTINË 21 GUSHT** - Legjislatura e VI sot (e enjte) pritet ta mbajë seancën e fundit, pasi partitë politike parlamentare në fillim të këtij muaji janë pajtuar që më 22 gusht të votojnë për shpërndarjen e Kuvendit. Paraprakisht, në seancën e cila fillon në orën 10:00, deputetët pritet ta votojnë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe më pas pikën e dytë të rendit të ditës, propozimin e grupit të deputetëve për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë të Kuvendit të Republikës së

Kosovës.

Deri më tani të gjitha partitë parlamentare janë zotuar publikisht se do të votojnë për shpërndarjen e Kuvendit, madje për këtë qëllim janë dorëzuar edhe 93 nënshkrime të deputetëve.

Me gjithë zotimet e liderëve politikë, ende ka dilema se mund të mos bëhen 80 votat e nevojshme për ta shpërndarë Kuvendin.

Menaxheri i projektit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e Kuvendit të Kosovës, Artan Murati, ka sqaruar procedurën e votimit lidhur me shpërndarjen potenciale të legjislaturës së gjashtë. "Ajo që dihet është që paku 93 nënshkrime të deputetëve janë dorëzuar për

ta thirrur seancën. Logjikisht, këta 93 deputetë duhet të jenë në Kuvend dhe të votojnë për atë çfarë kanë nënshkruar. Për të qenë votimi i suksesshëm, duhet që për shpërndarje të votojnë së paku 2/3 e deputetëve, që i bie 80 vota për. Kjo e përcakton edhe kuorumin", ka shkruar Murati në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka treguar se çfarë ndodhë nëse nuk votohet mocioni për shpërndarjen e Kuvendit. "Nëse votohet por nuk janë 80 vota për, në këtë rast Rregullorja është e heshtur. Duhet referuar pastaj te neni 81.1.1. i Kushtetutës dhe 83.1.a. i Rregullores së Kuvendit, ku thuhet se Kuvendi shpërndahet nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, prej

ditës së caktimit të mandatarit nga presidenti i Republikës së Kosovës nuk mund të formohet qeveria. Presidenti ka shtjerrë rastin e parë për mandatar, e ka edhe të dytin. Kjo do të sillte komplikime e vonesa, por eventualisht do të kryhej. Gjithsesi, subjektet politike veç e kanë shprehur publikisht qëndrimin e tyre. Koalicionet kanë filluar të formalizohen", ka shkruar Murati.

Pavarësisht prej skepticizmave të njohësve të rrethanave politike, liderët e partive politike shpërndarjen e Kuvendit dhe shkuarjen në zgjedhje të parakohshme e shohin si punë të kryer. Ata për këtë qëllim kanë finalizuar edhe disa koalicione parazgjedhore dhe kanë filluar mobilizimin e strukturave të tyre për zgjedhjet e reja. Nëse partitë iu përmbahen zotimeve të tyre dhe Kuvendi shpërndahet në këtë seancë, Kushtetuta e Kosovës parasheh që zgjedhjet e parakohshme të mbahen brenda 45 ditësh. Subjektet politike si data më të përafërta për zgjedhje e kanë përmendur 29 shtatorin dhe 6 tetorin.

## PRESIDENTI THAÇI TAKON KRYETAREN E KQZ-SË, KONSULTOHEN PËR ZGJEDHJET

Një ditë para seancës në të cilën pritet të shpërndahet Kuvendi dhe t'u hapet rruga zgjedhjeve të reja, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, me të cilën ka biseduar për përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve.

Presidenti Thaçi ka theksuar se menjëherë pas shpërndarjes së Kuvendit dhe pas dekretimit të datës së zgjedhjeve është e rëndësishme që të bëhen përgatitjet për të siguruar një proces fer dhe demokratik të zgjedhjeve. "Duhet të bëhen të gjitha përgatitjet teknike, profesionale si dhe të sigurohen mjetet buxhetore për të organizuar një proces zgjedhor i cili përmbush kriteret më të larta demokratike", ka shtuar presidenti Thaçi.

Ai ka thënë se edhe në këto zgjedhje duhet të ketë monitorim profesional nga organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare dhe mediet. Nga ana tjetër, kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se tashmë kanë filluar të bëhen përgatitjet teknike për organizimin e zgjedhjeve demokratike në Kosovë, pas shpërndarjes së Kuvendit dhe pas dekretimit të datës së zgjedhjeve nga ana e presidentit.



## Nait Hasani, ambasador i Kosovës në Shqipëri

**PRISHTINË, 21 GUSHT (ER)** - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Nait Hasani, është intervistuar të mërkurën nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike për ambasador të Kosovës në Shqipëri. Lajmin e ka bërë me

dije në llogarinë e vet në "Facebook" anëtar i këtij komisioni nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha. "Intervistimi i të propozuarit për ambasador në Republikën e Shqipërisë, z. Nait Hasani, në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike", ka shkruar Berisha.

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike i Kuvendit të Kosovës ia ka dhënë vizën Nait Hasanit për ambasador në Republikën e Shqipërisë. Tash mbetet në dorën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, nëse do ta akreditojë apo jo Nait Hasanin për ambasador në Shqipëri.



Flet për "Epokën e re", Bedri Istrefi

# Telekomi nuk është

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se Telekomi nuk është afër procesit të privatizimit as në aspektin procedural e as në atë të gjendjes momentale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në situatën aktuale në të cilën ndodhet Telekomi është e pamundur të privatizohet. "Po flitet dhe po proklamohet një privatizim që askund afër nuk është as në procedura dhe as në situatën në të cilën ndodhet Telekomi i Kosovës", ka thënë Istrefi, duke shtuar se deklaratat e tilla për privatizim më shumë i ngjasojnë fushatës elektorale sesa që ka diçka konkrete. Istrefi ka thënë se në momentin që ka marrë postin e kryeshefit ka targetuar disa projekte që të ketë stabilitet Telekomi dhe, sipas tij, një ndër to ka qenë ristrukturimi. Ai ka thënë se janë duke punuar shumë që të krijojnë një qëndrueshmëri në Telekomin e Kosovës

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 GUSHT -

**"Epoka e re":** Z. Istrefi, në çfarë gjendje është Telekomi i Kosovës?

**Istrefi:** Telekomi nuk është në gjendje të kënaqshme. Jemi duke punuar shumë që ta krijojmë një qëndrueshmëri. Këtë javë kemi pasur takime jashtëzakonisht pozitive për Telekomin. Me veprimet që do t'i marrim në ditët e ardhshme do të sigurohet një stabilitet afatgjatë.

**"Epoka e re":** Çfarë veprimesh?

**Istrefi:** Telekomi ka tre vjet e gjysmë që nuk ka kontratë të mirëmbajtjes dhe kemi një degradim të shërbimeve që po i bënë konsumatorët të jenë të pakënaqur. Me operatorin ekonomik jemi në kontakte të vazhdueshme dhe kemi arritur një paramarrëveshje dhe pavarësisht situatës që institucionet tona nuk na kanë mbështetur në aspektin financiar, jam zotuar se bashkërisht me stafin dhe me mundësitë tona do të arrijmë ta financojmë dhe ta përmbyllim këtë projekt. Sa më parë të fillojë implementimi i këtij projekti është më mirë, pasi garanton siguri në sistemet operative dhe kualitet të lartë me implementim të "Contry-Code". Andaj ka mundësi që të hyrat financiare që i kemi dhe që obligohemi ndaj "Monaco Telekomit" për shfrytëzimin e

kodit 377, që janë afërsisht 300 000 euro në muaj të rikthehen në Telekom. Në këtë mënyrë Telekomi do të fillojë ta marrë veten siç ka qenë më herët, po flas për vitet 2015-2016. Asnjëherë nuk marrë përgjegjësi që Telekomi do ta ketë nivelin që e kishte nga vitet 2009-2011. Shifrat e të hyrave kalojnë 5.5 milionë euro në muaj, por kemi obligime ndaj stafit, ndaj shtetit, siç është TVSh-ja, tatimi në fitim dhe në burim, si dhe obligimet ndaj operatorëve. Që të gjitha këto obligime kontraktuale kemi arritur t'i përmbyllim pa ndonjë telashe.

**"Epoka e re":** Si ishte ky sezon në aspektin financiar?

**Istrefi:** Pavarësisht prej problemeve që po ballafaqohemi çdo ditë, në saje edhe të fluksit të diasporës kemi pasur thyerje të rekordit për produktet që i kemi përzgjedhur. Kishim paketa atraktive dhe arritëm në rekordin që nuk ka qenë ndoshta nga fillimi i Telekomit. Po ashtu, "romerë", që janë konsumatorët që kalojnë nga një operator në tjetrin, ka pasur jashtëzakonisht shumë. Pra, kemi pasur mbi një milion kërkesa për kyçje. Mund t'ju them se kemi shënuar rekord të paparë përkundër sfidave në aspektin teknik.

**"Epoka e re":** Si qëndron Telekomi me institucionet e tjera sa iu përket shërbimeve dhe a po respektohet



marrëveshja me MAP-in?

**Istrefi:** Fatmirësisht, kemi një vendim nga OShP-ja dhe KRPP-ja që të gjitha shërbimet sa i përket fushës së telekomunikacionit, institucionet publike duhet t'i marrin tek operatori publik. Ai vendim na ka siguruar një punë më efikase që të jemi çdoherë pranë institucioneve tona me ofrimin e shërbimeve sipas kërkesës së tyre. Si proces ka ecur jashtëzakonisht mirë, por jemi të pakënaqur me disa institucione. Mund të themi lirisht se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, që është ministria e linjës së drejtpërdrejtë, ende nuk i ka shërbimet e Telekomit, por të atyre të konkurrencës. Gjithashtu, ka edhe institucione dhe komuna të tjera që nuk i kanë marrë shërbimet tona. Jemi në fazën kur duhet të përmbyllet një kontratë dhe më pastaj t'i nënshtrohemi një procesi tenderues, që pastaj

me kohë t'i bëjmë ankesat për çdo institucion i cili është i obligueshëm të lidhë kontratë me institucionin publik, në këtë rast me Telekomin e Kosovës.

**"Epoka e re":** Sa i përket platformës televizive, si qëndroni? Së fundi keni arritur marrëveshje me "TV Klan"-in.

**Istrefi:** Në vazhdimësi kishte kërkesa që Klani i Shqipërisë të jetë në platformën tonë. Ishte një ekskluzivitet i padrejtë nga konkurrenca dhe kemi bërë padi dhe kemi kërkuar mos të bëhet monopol. Pas negociatave për një vit, arritëm t'i kemi edhe shërbimet e "TV Klan"-it, pasi 90 për qind e ankesave të konsumatorëve ishin për këtë.

**"Epoka e re":** Kur do të jetë i qasshëm "TV Klan"?

**Istrefi:** Nga 1 shtatori.

**"Epoka e re":** Përfaqësues të "Deutsche Telekom"-it u takuan me ministrin Lluka lidhur me përgatitjen e Telekomit për ristrukturim. A jeni takuar edhe ju me këta përfaqësues?

**Istrefi:** Po, në të njëjtën ditë i kam takuar edhe unë. Patën një kërkesë që të krijohet një hartë e mundësisë së krijimit të kushteve, por çdo herë, sipas kërkesave të Telekomit, që të krijohet një proces ligjor më i mirë i mundshëm rreth privatizimit. Në situatën aktuale është e pamundur të privatizohet Telekomi. Ndoshta po flitet dhe po proklamohet një privatizim që askund afër nuk është, as në procedura dhe as në situatën në të cilën ndodhet Telekomi i Kosovës. Jemi marrë vesh me MZHE-në që të kemi së paku një ristrukturim të mirëfilltë i cili në minimum merr kohë gjashtë muaj deri në përfundim.

# ë afër privatizimit



**"Epoka e re":** Çfarë pritjesh keni nga ky ristrukturim dhe a duhet të hyjnë në të edhe pagat e larta të bordit dhe menaxhmentit?

**Istrefi:** Në bazë të marrëveshjes që kemi me MZHE-në dhe EBRD-në, parashihet që në komision të jenë tre anëtarë, nga EBRD-ja, MZHE-ja dhe një nga Telekomit. Tani janë në fazën përzgjedhëse të kompanisë, që pastaj në minimum ky proces zgjatë gjashtë muaj. Në situatën politike që ndodhemi mendoj se deklarimet nga ministria e linjës (MZHE-ja) për privatizim janë proklamime më shumë për fushatë elektorale sesa ka diçka konkrete. Në momentin që kam marrë postin e kryeshefit i kemi targetuar disa projekte që të kemi stabilitet dhe njëra ndër to ka qenë edhe ristrukturimi i Telekomit. Siç e dimë, nga viti 2005 Telekomit nuk ka

pasur strukturim të mirëfilltë. Çdo menaxhment që është ndërruar ka dalë nga struktura e organogramit dhe ka krijuar pozita fiktive, që më pas janë ngritur shpenzimet operative dhe, si të tilla, në momentin që ndodhemi, janë të pakonsumuara në aspektin që mund të kontribuojnë në situatën në të cilën ndodhemi. Së bashku me stafin kemi identifikuar që duhet të bëhet një nivelizim i pozitive dhe i gradës që afekton në aspektin financiar. Ka departamente dhe pozita që nuk kanë nevojë të jenë, të cilat krijojnë obligime financiare. Në bazë të një analize financiare që kemi nxjerrë, kemi targetuar si prioritet të madh shifrën prej 350-400 mijë eurosh që mund të jetë kursim mujor. Ne kishim filluar me procesin e tenderimit për një kompani ndërkombëtare që ta bëjë ristrukturimin, por që në përfundim kemi

pasur ndërhyrje nga ministria e linjës, MZHE-ja, që ky proces të ndalohet për shkak se MZHE-ja ka planifikuar që kjo të bëhet përmes IBRD-së dhe kemi humbur kohë nëntë muaj. Sikur të përzgjidhej atëherë kompania, tani procesi i ristrukturimit të Telekomit do të kishte përfunduar dhe planifikimi në të hyra financiare do të reflektohej. Tani, fatqësisht, kemi filluar me një proces tjetër të ristrukturimit dhe jemi në pritje të përfundimit të kompanisë, që do të marrë kohë minimumi gjashtë muaj. Sa iu përket pagave, janë të caktuara nga menaxhmenti i mëhershme. Kështu i kam gjetur dhe është e pamundur si kryeshef ekzekutiv të marr vendime për t'i ulur. Menaxhmentet e mëhershme kanë marrë vendime për ulje pagash, por që kanë pasur proceset gjyqësore, pasi punë-

torët janë ankuar nëpër gjykata dhe kanë aprovuar ankesën e tyre, kurse tani jemi duke e paguar një dëm jashtëzakonisht të madh pavarësisht prej situatës në të cilën gjendemi. Në mirëkuptim me kolegët jemi duke arritur një marrëveshje jashtëgjyqësore që ky obligim financiar i aprovuar nga gjykata të kryhet në mënyrë retroaktive. Jemi duke punuar ngushtë me sindikatën e Telekomit dhe duke u konsultuar çdoherë me ligje në fuqi se si të marrim veprime. Për menaxhmentin mund të them se janë pagat e lartë, ndërsa për stafin e brendshëm mendoj se i meritojnë pagat karshi punës që bëjnë.

**"Epoka e Re":** Sipas jush, kur do të ndodhë privatizimi dhe a rrezikohen punëtorët?

**Istrefi:** Nuk kisha dashur të

mendoj që me këtë proces të vijë deri te rrezikshmëria e punëtorëve. Telekomit ka investuar jashtëzakonisht në staf. Për 20 vjet është përgatitur ky staf dhe ju them se është aseti kryesor. Po ashtu, duhet të gjendet një strategji e leverdishme në mes të Telekomit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për pensionim të parakohshëm për punëtorët pasi moshë mesatare është 50-55 vjet dhe shteti duhet të ketë politika të një plani për pensionim të parakohshëm dhe, gjithashtu, të ketë skema të mira siç i kanë aplikuar vendet e rajonit. E ritheksoj mendimin tim dhe të menaxhmentit që nuk jemi kundër privatizimit, por që së pari duhet të krijohet një qëndrueshmëri dhe stabilitet brenda Telekomit. Në momentin që të dërgohet në privatizim, ta ketë një vlerë të merituar Telekomit pasi, siç e dimë, ky institucion këtij vendi i ka dhënë mbi 480 milionë dividendë dhe nuk e meriton trajtimin që i është bërë vitet e fundit dhe të vijë të një rezultat që të mendohet të jepet për hiçgjë.

**"Epoka e Re":** Ku ka mbetur çështja e fazës tranzitore për 300 mijë numrat e "Z-Mobile"-s dhe a ka shenja për ndonjë arbitrazh të mundshëm?

**Istrefi:** Në momentin që janë shpallur negociata të pasuksesshme pas ofertës së pranuar, bordi ka marrë vendim ta njoftojë "Dardafon"-in që ta ndërpresim çdo marrëdhënie të mundshme kontraktuale, pasi kontrata ishte e lidhur edhe me periudhën e licencave. Nga ai momenti ka filluar faza e tranzicionit. Kemi pasur takim të ekipeve të brendshme me "Z-Mobile" dhe kemi biseduar se si ta bëjmë implementimin sa më shpejt të fazës së tranzicionit. Jemi duke punuar dhe me ARKEP-in që mos të ketë më pas afekte ligjore, pasi kishim arbitrazhe të ndryshme. Po ashtu, jemi duke punuar edhe me ekspertë ligjorë të jashtëm dhe me Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por që primare është që konsumatori mos të jetë pa shërbime. E jona ka qenë që të gjitha veprimet që i kemi marrë të jenë konform ligjeve. Është e drejtë e gjithsecilit të bëjë si t'ia merr mendja.

# EPIK-u tregon se çfarë përfiton Kosova nga 90.5 milionë euro të IPA-s

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 GUSHT - Në shtator të vitit 2018 Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE) u morën vesh për marrëveshjen financiare për Instrumentin e Para-Anëtarësimit 2018. Marrëveshja u nënshkrua nga BE-ja në muajin shkurt, ndërkaq nga Kosova në muajin prill të vitit 2019. Kostoja totale e vlerësuar e programit IPA 2018 është 94,796,800 euro. Kontributi i BE-së është 90,500,000 euro, ndërsa institucionet e Kosovës do të sigurojnë bashkëfinansim prej 4,926,800 eurosh.

Nesër Kuvendi i Kosovës do të votojë Projektligjin nr. 06/L-161 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Marrëveshja ka paraparë financimin e reformave për avancimin e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, mjedisit, energjisë, arsimit dhe punësimit. "Në fushën e demokracisë dhe



qeverisjes së mirë do të financohet bursa 'Skema e Profesionistëve të Rinj' apo Young Cell Scheme (YCS). Me anë të bursës, të rinjtë e Kosovës do të kenë mundësi t'i vijojnë studimet Master në universitetet Evropiane. Po ashtu, do të financohet mbështetja për ngritje të kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës, si dhe do të sigurohet pagesa për pjesëmarr-

rjen e Kosovës në katër programet e BE-së", thuhet në komunikatën e institutit EPIK. Më tej theksohet se në fushën e sundimit të ligjit do të mbështetet përafrimi i kornizës ligjore dhe institucionale me standarde të BE-së si dhe fuqizimi i pavarësisë, profesionalizmit, llogaridhënies dhe efijencies së sistemit të drejtësisë. "Po ashtu, do të përkrat-

lufta kundër korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Në fushën e të drejtave themelore do të përkratet fuqizimi ekonomik i komuniteteve minoritare në Kosovë. Në fushën e mjedisit dhe energjisë do të ofrohen 40 milionë për adresimin e ndotjes së ajrit duke zëvendësuar elementet mjedisore të Kosovës B të cilat do të sigurojnë zvogëlimin e eme-

timeve të pluhurit dhe NOx-it. Po ashtu, 4.9 milionë euro do të ofrohen për deponinë sanitare në Pejë, si dhe zhvillimin e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbeturinave në gjithë Kosovën", është thënë në komunikatën e EPIK-ut.

Ndërkaq në fushën e arsimit, 13 milionë euro do të ofrohen për përmirësimin e sistemit arsimor në Kosovë, me theks për avancimin e qasjes së grupeve të cenueshme në sistemin arsimor, përmirësimin e rangimit të Kosovës në PISA, si dhe ndërlidhjen e sistemit arsimor me tregun e punës.

Në fushën e punësimit, 3 milionë euro do të ofrohen për financimin e ngritjes së konkurrueshmërisë së Kosovës dhe mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. "Me 3.7 milionë euro do të financohet dizajni i sallës së koncerteve, do përmirësohet qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike, si dhe do të avancohet komunikimi i asistencës së BE-së në Kosovë", është theksuar në komunikatën e EPIK-ut.

## Përurohët rinovimi i shërbimit të emergjencës në spitalin e Gjilanit

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 GUSHT - Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar qytetin e Gjilanit për ta përuaruar shërbimin e ri emergjencës në Spitalin e Gjilanit. Aty janë investuar rreth 200 mijë euro në infrastrukturë dhe pajisje mjekësore, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve mjekësore për pacientët.

Drejtori Sejdiu ka thënë se ky investim është bërë në vazhden e përmirësimit të kushteve për profesionistët shëndetësorë dhe pacientët. "Është prioritet yni që, përveç përmirësimit të infrastrukturës, bëjmë furnizimin me pajisje. Kemi përmendur vitin e

kaluar që prioritet për këtë vit do të jenë edhe spitalet rajonale, sepse të gjitha janë pjesë e sistemit tonë shëndetësor. Të gjitha këto po bëhen për të mirën e pacientit", është shprehur Sejdiu.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se investimet në Spitalin e Gjilanit do të krijojnë një ambient më të mirë pune për stafin shëndetësor, i cili do të jetë në gjendje t'i ofrojë shërbime cilësore pacientit. "Është kënaqësi me qenë sot këtu me juve, me gjithë personelin shëndetësor, të cilin e kemi edhe sot pas vetes dhe të cilët për një kohë të gjatë kanë pritur që të kenë ambiente më të mira, që të kenë mundësi t'ua ofrojnë pacientëve tanë më të mirën, duke pasur pajisje më moderne", ka theksuar Ismaili.

Nisret Hajrullahu, drejtor i



Spitalit të Gjilanit, u shpreh i kënaqur me investimet e bëra, ndërsa tha se përmirësimi i kushteve në emergjencë rrit

kualitetin e punës. "Është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë, e cila do ta rrisë cilësinë e punës. Është ndërruar inventari deri te

aparatura mjekësore. Gjithçka do të jetë në shërbim të pacientit dhe qytetarit të Gjilanit", ka thënë Hajrullahu.

## AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 49

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 49 përmes metodës së likuidimit ka pranuar numrin prej 121 ofertave për 131 asete të shpallura për shitje. Vlera e tërësishme e ofertave më të larta arriti shumë prej 8,073,467 eurosh.

Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi drejtpërdrejt i ceremonisë

nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org) si dhe është transmetuar drejtpërdrejt edhe nëpërmjet agjencisë së lajmeve kosovapress.com, duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe për të gjithë qytetarët e interesuar që s'kanë qenë të pranishëm në sallë.



# Veseli: Milionat e konfiskuara nga pasuria e paligjshme do të investohen në vende të reja të punës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë me dije se pasuria e sekuestruar nga kriminelët dhe keqpërdoruesit e taksave ka arritur afër 40 milionë euro. Ai ka premtuar se milionat e konfiskuara nga pasuria e paligjshme do të investohen për krijimin e vendeve të reja të punës. Këto komente Veseli i ka bërë gjatë vizitës në Depon Qendrore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar në të cilën gjenden asetet e konfiskuara dhe të sekuestruara nga ana e institucioneve të sistemit të drejtësisë

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të mërkurën ka vizituar depon qendrore të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar në të cilën gjenden asetet e konfiskuara dhe të sekuestruara nga ana e institucioneve të sistemit të

drejtësisë. Me këtë rast, kryeparlamentari Veseli ka bërë me dije se me punë të pandalshme pasuria e sekuestruar nga kriminelët dhe keqpërdoruesit e taksave ka arritur në 40 milionë euro. Ai ka thënë se këto miliona do të investohen për krijimin e vendeve të reja të punës. "Abelard Tahirit si politikan i ri premtues i kam dhënë mundësinë ta dëshmojë veten si ministër i Drejtësisë gjatë këtyre dy vjetëve. Me punë të pandalshme, pasuria

e sekuestruar nga kriminelët dhe keqpërdoruesit e taksave ka arritur në afër 40 milionë euro. Këto miliona do të investohen për krijimin e vendeve të reja të punës, për krijimin e mundësive për të rinj, që të mund të qëndrojnë këtu dhe së bashku të ndërtojnë një të ardhme më të mirë për shtetin. Në vend të veturave luksoze të pasanikëve të korruptuar, do të kemi investime cilësore për të rinjtë", ka deklaruar Veseli, duke shtuar

se ky është një shembull i luftës kundër korrupsionit. "Ky është një shembull i luftës kundër korrupsionit dhe një prej mënyrave më të mira për ta vazhduar luftën është promovimi i njerëzve të rinj dhe kompetent si Abelard Tahiri", është shprehur Veseli.

Kurse ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se konfiskimi i pasurisë së paligjshme ka qenë dhe do të mbetet prioritet edhe në të ardhmen. "Konfiskimi i pasurisë së paligjshme ka qenë dhe do të mbetet prioritet themelor edhe në të ardhmen dhe instrument kryesor në luftën tonë kundër korrupsionit. Vlera e aseteve të konfiskuara dhe sekuestruara deri më tani ka arritur rreth 40 milionë euro. Gjithë kjo është arritur falë miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës të Ligjit të ri për

Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe vendosmërisë së kryetarit Veseli për angazhimin dhe mbështetjen e tij për prioritizimin e kësaj agjende jashtëzakonisht të rëndësishme për institucionet e rendit dhe ligjit", ka thënë ai.

Sipas Tahirit, konfiskimi i pasurisë së paligjshme është hallka kryesore për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Konfiskimi i pasurisë së paligjshme ka qenë hallka më e dobët e sistemit të drejtësisë por, falë politikës së re që kemi shtyrë përpara, sot është duke u bërë dhe do të bëhet edhe më tej, hallka kryesore për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ka qenë përkushtimi im si Ministër i Drejtësisë dhe mbështetja vendimtare e kryetarit të Kuvendit, z. Veseli, që ta shtrojmë me prioritet një politikë të re e shumë më të fuqishme në fushën e konfiskimit të pasurisë së paligjshme", është shprehur ai.

Ministri Tahiri ka deklaruar se me konfiskimin e pasurisë do të dërrmohen të korruptuarit kudo që janë, në biznes apo në politikë. "Efektet e zbatimit të ligjit të ri po vërehen dukshëm dhe që nga hyrja në fuqi në fillim të vitit 2019 kjo politikë e re mundësoi konfiskimin e secilës pasuri të fituar nga aktiviteti kriminal. Me ligjin e ri, kemi hapur front të ri kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Grupet kriminale dhe të korruptuarit jetojnë duke shfrytëzuar pasurinë e fituar me krim dhe korrupsion, prandaj nuk është e mjaftueshme vetëm kapja dhe ndalimi i tyre, por edhe konfiskimi i secilës pasuri të paligjshme. Konfiskimi i pasurisë do t'i dërrmojë të korruptuarit kudo që janë, si në sferën e biznesit, po ashtu edhe në politikë", ka theksuar Tahiri.



## Haradinaj: Sfidë mbetet njohja e Kosovës nga pesë vendet e BE-së

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion prej 50 studentësh të programit Akademia Verore nga shtete të ndryshme të botës. Ai i ka falënderuar studentët për përzgjedhjen e tyre që ta vizitojnë Kosovën dhe mundësinë që të mësojnë më shumë për kulturën, traditën dhe të arriturat e vendit. "Faleminderit që jeni në Kosovë, në një vend që ka rini. Jemi më të rinjtë në Evropë, por edhe në botë. Janë bërë 11 vjet që nga pavarësia dhe synimi ynë është të bëhemi anëtarë të Kombeve të Bashkuara, derisa

aspirata jonë është që t'i bashkohemi NATO-s, familjes së madhe evropiane, sepse kjo është bota jonë. Vendi ynë ka edhe shumë sfida të tjera përpara, po për të cilat po angazhohemi me përkushtim që t'i kthejmë në të arritura dhe në rezultate konkrete", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se sfidë mbetet njohja e Kosovës nga pesë vendet e BE-së. Ai u ka treguar të pranishmëve se Kosova dhe Serbia aktualisht janë në proces të dialogut dhe synojnë arritjen e një marrëveshjeje për njohje me kufijtë ekzistues.

Kryeministri ka thënë se Kosova ka kryer të gjitha obligimet



karshi liberalizimit të vizave dhe po punon për integrim në BE. "Ne kemi ndërtuar marrëdhënie të mira me shtetet fqinje dhe jemi të interesuar për dialog me Serbinë. Tarifat nuk

janë pengesë, por mosgatishmëria e shtetit serb që ta njohë realitetin në Kosovë, ta njohë Kosovën shtet", ka thënë Haradinaj. Kryeministri ka folur edhe për

sfidat në ekonomi dhe për krijimin e vendeve të reja të punës. Haradinaj u ka treguar studentëve se dorëheqja nga posti i kryeministrit është bërë për ta mbrojtur shtetin e Kosovës.

## 12 familje skamnore në Skenderaj bëhen me shtëpi të reja

SKENDERAJ, 21 GUSHT (ER) - Dymbëdhjetë palë çelësa janë dhuruar për dymbëdhjetë familje në Skenderaj, në mesin e të cilave veteranë e invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), mësimsdhënës, të moshuar e të vegjël, të cilët nisin jetën e re në shtëpitë e reja, për t'i lënë prapa kujtimet e objekteve ku deri dje kishin jetuar në kushte të këqija. Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se falë bashkëpunimit me humanistin

Halil Kastrati dhe Shoqatën "Jetimët e Ballkanit", me të cilën Komuna e Skenderajt ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për ndërtimin e këtyre shtëpive, po u kthehet fëmijëve dhe familjeve të tyre buzëqeshja e shoqëruar me lotët e gëzimit. "Falë bashkëpunimit të mrekulueshëm me humanistin Halil Kastrati dhe Shoqatën 'Jetimat e Ballkanit', me të cilën Komuna e Skenderajt ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit (obligimi i komunës 5 000 euro

për çdo shtëpi) për ndërtimin e këtyre shtëpive, po u kthehet fëmijëve dhe familjeve të tyre buzëqeshja e shoqëruar me lotët e gëzimit", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook". Jashari ka thënë se janë vetëm në gjysmën e rrugëtimit dhe deri në përmbyllje të këtij projekti do të ndërtohen edhe 14 shtëpi të tjera. Familjet përfituese të 12 shtëpive të reja janë: Astrit Krasniqi e Hajriz Hyseni (Vajnik), Jashar Miftaraj e Muhamet Miftaraj



(Runik), Halim Smakaj (Kopiliq i Poshtëm), Skender Klladernicë, Selman Azemi Kajtazi (Vitak), Rustem Gjeloshi (Çubrel) dhe Hatixhe Hoti (Turigec).

## BERZh-i pranon konceptnotën për financimin e unazës së brendshme të Prishtinës

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka pranuar konceptnotën për financimin e unazës së brendshme të kryeqytetit, pas kërkesës për financim që e ka bërë Republika e Kosovës. Ahmeti ka thënë se ky projekt kap vlerën e 100 milionë eurove. "Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) ka pranuar konceptnotën për financimin e unazës së brendshme të kryeqytetit, pas kërkesës për financim që e ka bërë Republika e Kosovës. Ky projekt do ta arrijë vlerën rreth 100 milionë euro. BERZh-i tashmë ka ndarë rreth 1 milion euro për konsulencë për studimin përfundimtar të fizibilitetit dhe dizajnit preliminar.

Ky studim do të fillojë në nëntor të këtij viti pas përzgjedhjes së kompanisë konsulente", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se raporti përfundimtar i fizibilitetit për këtë projekt do të përfundojë në qershor të vitit 2020 dhe do të vendoset në diskutim publik 120 ditë. "Gjatë këtij diskutimi publik katër muajsh qytetarët do të kenë të drejtë ta japin kontributin e tyre qoftë pronarët e tokave që preken nga kjo unazë, qoftë të tjerët që kanë ide për zhvillimin sa më të mirë të projektit. Në vjeshtën e vitit 2020 do të tenderohet unaza që do t'i lehtësojë bukur shumë lëvizjet në kryeqytetin tonë. Në foto me të kuqe shihen hollësitë e unazës së brendshme nga planet komunale në fuqi", ka shkruar Ahmeti.



## MASHT-i fillon ndërtimin e shkollës së re në Glllogjan



DEÇAN, 21 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, së bashku me kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë vënë gurthemelin e Shkollës Filllore "Heronjtë e Dukagjinit" në Glllogjan dhe kanë parë nga afër ecurinë e punimeve të objektit përcjellës të Shkollës Filllore "Isa Boletini" në Isniq. Ministri Bytyqi me këtë rast ka thënë se duhet kujtuar të kaluarën heroike sa herë që kemi festa dhe përuime, të kaluarën e

lavdishme për të cilën dha shumë Glllogjani me rrethinë. Ai ka thënë se ndihet i kënaqur që gjendet në mesin e qytetarëve të Glllogjanit, të cilët në ditët më të vështira ishin në gjendje të mbronin gjuhën dhe vendin, ndërkaq foli edhe për rolin patriotik që pati kjo shkollë, sikurse shumë shkolla të tjera, duke shërbyer edhe si bazë e UÇK-së, nga ku mbrohej popullata dhe vendi. "Sot po fillojmë ndërtimin e një shkolle. Uroj të gjithë banorët e kësaj ane, mësimsdhënësit dhe nxënësit që

ta gëzojnë këtë shkollë, e cila do të jetë sipas standardeve të larta evropiane. Kjo shkollë do të ofrojë mundësi që nxënësit të përfitojnë dituri dhe shkathësi, sikurse bashkëmoshatarët e tyre të vendeve evropiane", është shprehur ministri Bytyqi. Ndër të tjera, ministri Bytyqi ka theksuar se ajo çfarë mbetet obligim është angazhimi i gjithëmbarshtëm për t'i përgatitur brezat e rinj, në mënyrë që ata të marrin përgjegjësi për të udhëhequr dhe zhvilluar shtetin.

## Drejtori i 'Don Bosko'-s nderohet nga Haziri me mirënjohje për kontributin në arsim

GJILAN, 21 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar drejtorin e shkollës "Don Bosko", Don Dominik Qerimi, me rastin e përfundimit të misionit në këtë institucion. Me këtë rast, kryetari Haziri e ka nderuar me mirënjohje Qerimin për kontributin në udhëheqjen e

këtij institucioni, sikurse edhe për bashkëpunimin në kuadër të dialogut ndërfetar në Gjilan. "Don Dominiku është shembulli i njeriut që suksesin e bartë në institucion dhe komunitet të Gjilanit, duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në 'Don Bosko', por edhe në Komunën e Gjilanit. E

falënderoj dhe i uroj suksese edhe në të ardhmen", ka thënë Haziri. Ndërsa drejtori i shkollës "Don Bosko", Don Dominik Qerimi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për mirënjohjen dhe bashkëpunimin e jashtëzakonshëm në disa fusha në të mirë të gjilanasve.





## Përfundon protesta e punëtorëve të Aeroportit të Prishtinës

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Punëtorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kanë përfunduar të mërkurën grevën e tretë me radhë që ka nisur nga ora 8:00 e mëngjesit deri në orën 14:00.

Gjashtë orë sa ka zgjatuar greva nuk ka pasur ndonjë pengesë për realizimin e fluturimeve, ka thënë Valentina Gara, zëdhënëse në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. "Kompanitë ajrore vendosin vetë a do t'i anulojnë fluturimet pas paralajmërimeve

zyrtare se do të ketë grevë. Fluturimet të cilat janë paraparë të realizohen sot janë realizuar sipas planit", ka thënë Gara, duke shtuar se në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës nuk janë mbyllur operimet.

Gjatë mbajtjes së grevës, në hapësirat e Aeroportit të Prishtinës të pranishëm kanë qenë edhe pjesëtar të Policisë së Kosovës.

Zbatimi i Kontratës Kolektive është një nga kërkesat e punëtorëve, por e cila, sipas menaxhmentit të

Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, konsiderohet joligjore. Kontrata Kolektive parasheh shujtën, shpenzimet e udhëtimit dhe pagën jubilarë çdo dhjetë vjet për punëtorët.

Kontrata Kolektive në Kosovë është një marrëveshje e arritur në bazë të Ligjit të Punës dhe, si e tillë, ligjërisht rregullon të drejtat e punëtorëve në sektorin publik dhe privat. Ndërkohë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ka përkrahur kërkesat e punëtorëve.



# 200 mijë euro për hapjen e Qendrës Multifunktionale Inovative në Shtime

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

SHTIME, 21 GUSHT - Ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ka nënshkruar memorandum të bashkëpunimit me kryetarin e Komunës së Shtimes, Naim ismajli, për rregullimin e Qendrës Multifunktionale Inovative në Shtime. Ministri Shala ka bërë me dije se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të investojë 200 mijë euro për rregullimin e kësaj qendre, e cila do të shërbejë për bizneset, të rinjtë dhe individët që duan të merren me fushën e teknologjisë informative dhe inovacionit.

Ministri Shala, pas nënshkrimit të memorandumit, ka thënë se hapja e kësaj qendre multifunktionale do të krijojë mundësi të reja për të rinjtë dhe implementimin e ideve të tyre inovative. "Kjo marrëveshje është vazhdimësi e marrëveshjeve të tjera për të krijuar qendra të reja multifunktionale për inovacion. Qendra Multifunktionale Inovative në Shtime do të shërbejë për krijimin e 50 mijë inxhinierëve të IT-së, pasi është nevojë edhe e tregut, pjesa tjetër do të shërbejë edhe për krijimin e 5000 Start-up bizneseve inovative që është edhe një nga objektivat e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë", ka thënë ai.

Ministri në detyrë, Shala, ka



thënë se janë duke i hulumtuar modelet më të mira të qendrave të inovacionit, për të krijuar sa më shumë hapësira për të rinjtë, bizneset dhe individët. "Kjo hapësirë është e destinuar për studentët, ndërmarrjet inovative në proces të parainkubimit dhe inkubimit dhe për të rinjtë e interesuar për përgatitje profe-

sionale në fushën e inovacionit. Qendra Multifunktionale Inovative nuk do të jetë sikur qendrat e tjera të inovacionit, por do të përfshijë një domen më të gjerë të veprimtarisë pasi që brenda saj do të ketë edhe salla të trajnimeve për të rinjtë në fushën e teknologjisë informative, inxhinierisë dhe

zhvillimit të softuerit", ka thënë ministri në detyrë i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Shtimes, Naim Ismajli, ka thënë se investimi i 200 mijë eurove për hapjen e Qendrës Multifunktionale Inovative do të hapë perspektiva të reja për të

rinjtë e kësaj ane.

Deri më tani janë nënshkruar marrëveshjet për krijimin e Qendrës së Inovacionit në Ferizaj, asaj në Universitetin e Prishtinës, në Universitetin e Mitrovicës, kurse Ministria e Inovacionit është në proces të krijimit të qendrës së inovacionit edhe në Pejë.

## Hapet faza e dytë e programit të vetëpunësimit

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skënder Reçica, ka bërë me dije të mërkurën se është hapur faza e dytë e programit të vetëpunësimit. Ai ka treguar se nëpërmjet këtij programi do të mbështeten rreth 50 punëkërkuar të riatdhesuar në tërë Kosovën dhe 21 punëkërkuar të rregullt në rajonin e Prishtinës dhe Mitrovicës. "Përpjekjet tona

për rritje të mundësive për punëkërkuarët e papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit, nëpërmjet kyçjes së tyre në masa aktive të tregut të punës, kanë qenë të vazhdueshme dhe në rritje. Pas suksesit të fazës së parë të Programit të Vetëpunësimit, nëpërmjet të cilit u kemi dhënë rastin 144 punëkërkuarëve të riatdhesuar në tërë Kosovën dhe 29 punëkërkuarëve të rregullt në

rajonin e Prishtinës dhe Mitrovicës, bashkë me partnerin tonë UNDP sot shpallim të hapur fazën e dytë të Programit të Vetëpunësimit. Nëpërmjet tij do të mbështesim rreth 50 punëkërkuar të riatdhesuar në tërë Kosovën dhe 21 punëkërkuar të rregullt në rajonin e Prishtinës dhe Mitrovicës. Programi do të jetë i hapur për aplikim nga sot deri më 30 shtator 2019", ka bërë me dije Reçica.



# BE-ja SHTYN ZGJERIMIN E BALLKANIT PERËNDIMOR



Prof. Dr. Blerim REKA

Samiti i qershorit i Këshillit Evropian shoi ambiciet e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që duan të anëtarësohen në BE, duke i thyer shpresat se çdo vend i rajonit mund të aderonte përpara vitit 2030. Më herët, Brukseli kishte folur për 2025. KE-ja përsëri vonoi fillimin e negociatave të anëtarësimit për Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë, mezi e pranoi përparimin që Mali i Zi dhe Serbia në negociatat e tyre, dhe praktikisht injoruan Kosovën dhe Bosnjë e Hercegovinën, duke mos përmendur rrugën e pranimit të tyre.

BE-ja aplikoi një qasje 2 + 2 + 2 për rajonin: dy kandidatë "seriozë" (Mali i Zi dhe Serbia); dy "çiftin në pritje" (Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria); dhe dy kandidatë "jo të sigurt" (Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova). Kjo e fundit, madje, pa regjim me BE. Samiti BE-Ballkan Perëndimor, që ishte planifikuar për 1 korrik në Paris, u shty deri në shtator. Për më tepër, presidenti Francez Emmanuel Macron nuk mori pjesë as në konfer-

encën e Procesit të Berlinit në Poznan, Poloni, më 4-5 korrik. Ai ka thënë publikisht se kundërshton çdo zgjerim para se të bëhen reformat institucionale në BE.

Politika e presidentit Macron për BE-në: "thellësia para gjerësisë", në esencë do ta vonojë zgjerimin edhe për një dekadë tjetër, me pasoja të rëndësishme gjeopolitike për rajonin. Të lodhur nga marrja e dushit të ftohtë nga Brukseli, këto gjashtë vende mund të bien gradualisht në rrugën e Turqisë: të trembur nga BE-ja, ato do ta shmangin atë.

Ekonomitë e tyre tashmë të brishta do të përjetojnë një ulje të investimeve të huaja direkte (IHD), rritje të shpërnguljeve dhe forcim të regjimeve autoritare dhe oligarkike. Një e katërta e popullsisë së rajonit tashmë është larguar dhe më shumë se gjysma e të rinjve ende atje synojnë të shpërngulen jashtë vendit. Një studim i fundit tregoi se më shumë se 60 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor janë të shqetësuar për papunësinë dhe 47 për qind për ekonominë në përgjithësi. Vetëm 50 për qind janë të kënaqur me qeveritë e tyre, ndërsa 70 për qind shprehin mungesë besimi në sundimin e ligjit.

## Ndryshimi në fokus

Në 2004-n BE-ja pati një zgjerim të madh, duke sjellë 10 vende të reja. Bullgaria dhe

Rumania u bashkuan në vitin 2007, ndërsa Kroacia u anëtarësua në vitin 2013. Pas kësaj, politika e zgjerimit hyri në një pauzë.

Gjeopolitika e kishte nxitur kryesisht procesin e zgjerimit: pas integritit me NATO-n, ish-shtetet e Paktit të Varshavës të Evropës Qendrore dhe Lindore së bashku me dy shtetet - ishuj mesdhetare (Malta dhe Qipro) që kishin qenë me rëndësi strategjike gjatë Luftës së Ftohtë, ishin anëtarësuar edhe në BE. Sot pauza në zgjerim erdhi si pasojë e zhvendosjes së përqendrimit të BE-së, nga gjeopolitika në çështje teknike. Ana gjeopolitike i është lënë NATO-s. Aleanca ka integruar tashmë Shqipërinë dhe Malin e Zi, ndërsa Maqedonia Veriore do të bashkohet së shpejti. BE-ja është përqendruar në teknikat politike. Kjo tregon pse Shqipëria, tashmë anëtare e NATO-s për 10 vjet, ende nuk ka filluar as bisedimet e pranimit në BE.

Ndryshimi i strategjisë së BE-së buroi nga një mësim që Brukseli e mori nga vala e fundit e zgjerimit. Duke lejuar faktorët gjeopolitikë të mbizotërojnë vendimet e zgjerimit, disa anëtarë të rinj u lejuan që të mos përmbushnin kriteret e ashtuquajtura të Kopenhagës (juridike, politike dhe ekonomike) dhe ato të Madridit (administrative). Të paktën tre prej tyre ishin më pak të përgatitur sesa kandidatët aktualë nga Ballkani Perëndimor dhe dy të tjerët u

sanksionuan nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë për moszbatim të sundimit të ligjit. Një dekadë më parë justifikimet për ndërprerjen e zgjerimit ishin "lodhja nga zgjerimi" dhe "mungesa e kapaciteteve absorbuese". Tani justifikimi është thirrja e presidentit Macron për reforma - para zgjerimit. Disa madje kanë propozuar që zgjerimi të mbetet jashtë tryezës. Deputetja franceze Nathalie Loiseau, për shembull, ka sugjeruar që për shkak se vendet e Ballkanit Perëndimor "nuk janë aspak të gatshme" për anëtarësimin në BE, blloku duhet të vendosë një partneritet të ngushtë me ta.

Prandaj është e qartë se pa stabilitet rajonal ose pa përmirësim në zbatimin e shtetit të së drejtës, pranimi në BE për Ballkanin Perëndimor nuk ka të ngjarë që të ndodhë së shpejti. Maqedonia e Veriut, përpara se të merrej vesh me Greqinë për emrin e saj, po mbahej peng për negociatat anëtarësuese vetëm nga Athina. Tani që Greqia ka hequr kundërshtimet e saj, Shkupi përballet me tri veto të reja nga shtetet e tjera anëtare për t'i filluar negociatat. Është gjithashtu e paqartë nëse mund të fillojnë këto negociata edhe me Shqipërinë.

Skenari më i mundshëm është vonesa prej një dekade e procesit të integritit për shkak të tri pengesave kryesore: politikës në vendet anëtare, burokracisë së Brukselit dhe interesave të

fuqishme strategjike në Ballkanin Perëndimor. Duke përfutur nga mungesa e reformës, elitat në rajon mund të pretendojnë ta dëshirojnë anëtarësimin në BE. Brukseli mund të pretendojë t'i dëshirojë ato shtete në BE.

Me këtë ritëm, anëtarësimi deri në vitin 2030 duket i pamundur. Kroacisë iu deshën shtatë vjet vetëm për negociatat e saj, këto vende mund të presin që për to shumë më gjatë. Mali i Zi ka mbyllur vetëm tre nga 35 kapitujt e bisedimeve pas gjashtë vjetësh. Serbia ka mbyllur vetëm dy në pesë vjet. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet t'i fillojnë ende bisedimet e tyre, ndërsa Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina ende nuk janë as kandidatë zyrtarë.

## Banana Republikat e Ballkanit

Mungesa e përparimit drejt anëtarësimit në BE gjithashtu po ndikon në dinamikën e brendshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kapja e shtetit nga interesat e fuqishme rrezikon t'i shtyjë këto vende në zonën e shteteve të dështuara: gjyqtarët e politizuar, zyrtarët e korruptuar dhe administratat nepotiste janë bërë normë. Në dekadën e fundit ish-kryeministat në tre shtete anëtare të BE-së u arrestuan për korrupsion. Ndërkaq, nuk ka pasur pasoja të tilla për udhëheqësit në

## Drejtorja për Arsim dhe Edukim në Malishevë po harton planet vjetore dhe mujore të bazuara në kurrikulë

MALISHEVË, 21 GUSHT (ER) - Pasi fillimi i vitit të ri shkollor 2019/2020 është afër, Drejtorja për Arsim dhe Edukim në Komunën e Malishevës është në fazën përmbyllëse të përgatitjeve tekniko-teorike jo vetëm në meremetimin e objekteve shkollore, por që të fillojë një vit mësimor dhe të realizohen pritjet cilësore në të tri nivelet që zhvillohet mësimi

në Komunën e Malishevës, koordinatori i DAE-së, Halim Hoti, ka organizuar punëtori dyditore me ekspertët e pesë fushave dhe aktivitete profesionale të tri niveleve, për hartimin e planeve vjetore dhe mujore të bazuara në kurrikulën e cila është në zbatim nga MASH-T-i.

Këto dokumente bazë për mësimdhënësit do të ndihmojnë

që standardet e planifikuara në secilën lëndë, klasa dhe nivele, të janë më të unifikuara si dhe treguesit e pritjeve të rezultateve në periudha vlerësuese të jenë më të mundshme për identifikim dhe rekomandim për realizim, këtë do ta bëjnë mentoruesit dhe monitoruesit e këtij procesi. Këto plane do t'u shpërndahen shkollave me qëllim që



t'u ndihmohet mësimdhënësve për zbatimin praktik të kurrikulës së re në

mësimdhënie dhe mësimnxënie, ku edhe sukcesi do të shënojë ngjitje.

Ballkanin Perëndimor, me gjithë korrupsionin e përhapur në mesin e elitave politike.

Një raport mbi Maqedoninë e Veriut nga Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) renditi 23 rekomandime për luftimin e korrupsionit. Vendi pritet të paraqesë një raport mbi përparimin e tij në zbatimin e tyre deri në vitin 2020. Në Shqipëri, procesi i verifikimit të gjyqtarëve filloi dy vjet më parë. Deri më tani, 140 nga 800 gjyqtarë janë verifikuar. Më pak se 10 për qind kanë humbur punën e tyre për shkak të konstatimeve, megjithëse kryetari i Gjykatës Supreme të vendit u fajësua kohët e fundit. Në Maqedoninë e Veriut, disa gjyqtarë kryesorë janë paditur, por vetëm në disa raste gjykimi ka vazhduar. Nga nëntë gjyqtarë të dyshuar për korrupsion, asnjëri prej tyre nuk u suspendua. Verifikimi i policisë do të fillojë në vjeshtë. Një komision antikorrupsion u krijua vitin e kaluar, por kompanitë në pronësi të qeveritarëve ose të lidhura me ministrat e qeverisë ende priren të fitojnë kontrata fitimprurëse. E njëjta gjë është e vërtetë për Serbinë, një hetim i fundit në gazetë zbuloi se shumica e kompanive që fitojnë tenderët e qeverisë kanë lidhje me politikanët të fuqishëm.

Rrallë ndonjë skandal i madh i korrupsionit të përfundojë me dënim gjyqësor, prandaj kjo është arsyeja pse njerëzit në Ballkanin Perëndimor kanë aq pak besim te gjyqtarët. Rreth 57 për qind e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut nuk besojnë as në Zyrën e Prokurorit Special, e themeluar në vitin 2015, për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Në 18 çështjet që ka sjellë kjo zyrë para gjykatës, vetëm një nga gjithsej 90 të akuzuarit përfundoi në burg. Prokurorja speciale Katica Janeva dha dorëheqje më 15 korrik, në të njëjtën ditë kur u arrestuan dy biznesmenë, të cilët ajo i akuzonte për zhvatje

parash me shantazh. Dyshimet kishin lindur se ajo ishte përfshirë në skandal. Në Shqipëri, Gjykata Kushtetuese ka qenë jofunksionale për gati dy vjet për shkak të hetimit për korrupsionin ndaj gjyqtarëve të saj.

A mund të fajësohen qytetarët e rajonit për mosbesim te gjyqësori?

### Mosfunksionimi ekonomik

Shumica e 20 milionë njerëzve në rajon janë të pakënaqur me mënyrën se si po shkojnë gjërat në ekonomitë e tyre. Për shembull, sipas studimit të Barometrit të Ballkanit, 69 për qind e shqiptarëve, 68 për qind e boshnjakëve dhe 50 për qind e kosovarëve janë ose "plotësisht" ose "kryesisht" të pakënaqur me ekonomitë e tyre. Kjo pakënaqësi e përgjithshme në rajon është për shkak të pagave të ulëta: mesatarja e pagës minimale është tetë herë më e vogël sesa në vendet anëtare të BE-së.

Pavarësisht se është i pasur me burime natyrore, rajoni mbetet një nga më të varfrit në Evropë. Kosova me rezervat e mëdha të qymyrit dhe linjitet zë vendin e pestë në botë, me rreth 14 miliardë tonë. Ajo gjithashtu ka rezerva të bollshme prej ari, argjendi dhe zinku. Serbia ka edhe rezerva të mëdha të qymyrit, ndërsa burimet e konsiderueshme të naftës dhe gazit u zbuluan kohët e fundit në Shqipëri. Asnjë nga këto nuk mund të shfrytëzohet pa investime të huaja, të cilat nuk do të arrijnë derisa bizneset të ndihen sikur mund t'u besojnë sistemeve ligjore në rajon.

Sipas Raportit të Investimeve Botërore të Kombeve të Bashkuara për vitin 2019, rajoni tërhoqi vetëm rreth 7.4 miliardë dollarë në FDI vitin e kaluar. Serbia pati një rritje gati 44 për qind të FDI-ve në vitet 2017 dhe 2018, në 4.1 miliardë dollarë. Shifrat në pjesën tjetër të rajonit ishin shumë më pak

mbresëlënëse. FDI-të në Mal të Zi madje u ulën 12 për qind me një pjesëmarrje prej 490 milionë dollarësh. Bosnjë e Hercegovina tërhoqi vetëm 468 milionë dollarë, Maqedonia e Veriut 737 milionë dollarë dhe Shqipëria 1.3 miliardë dollarë. Pa më shumë FDI, vendet e rajonit nuk do të jenë në gjendje t'i përmirësojnë ekonomitë e tyre. Anëtarësimi i tyre në BE do t'i rrisë gjithashtu fondet e BE-së në rajon. Rasti i Bullgarisë është ilustrues: ajo ka përdorur rreth 30 miliardë euro nga financimi i BE-së. Vendet e Ballkanit janë të përfshira në fondet e "instrumentit për asistencë para-pranimi" (IPA), por mungesa e aftësive të brendshme administrative dhe institucionale do të thotë se jo të gjitha paratë shfrytëzohen. Për shembull, Maqedonia e Veriut ka shfrytëzuar vetëm 30 për qind të fondit të saj të përcaktuar për zhvillim rural IPA. Korrupsioni gjithashtu zhduk paratë e BE-së të destinuar për zhvillim.

Procesi i Berlinit ofroi një alternative për vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i financuar projektet e infrastrukturës dhe energjisë. Në samitin e mbajtur në Poznan, për këto qëllime u premtua një grant i BE-së prej 180 milionë eurosh.

Klima e përgjithshme e pasigurisë në Ballkan ka shkaktuar një valë emigracioni, nga njëra anë duke shkaktuar një ikje të trurit, nga ana tjetër duke siguruar një burim të ardhurash për rajonin. Si Kosova ashtu dhe Maqedonia e Veriut marrin rreth 1 miliard euro remitanca në vit. Për më tepër, në të gjashtë vendet, hendeuku midis të pasurve dhe të varfërve po rritet prapë për shkak të korrupsionit dhe gjendjes së brishtë të ekonomive të tyre.

### Skenarët

Skenari më i mundshëm është që kundërshtimi i presidentit Macron ndaj zgjerimit të BE-së do ta shtyjë procesin e pranimit të Ballkanit Perëndimor edhe

për një dekadë tjetër. Me kancelaren gjermane Angela Merkel në largim nuk do të mbetet asnjë udhëheqës evropian që ta sfidojë Macronin dhe të shtyjë një agjendë zgjerimi përpara. Edhe me Merkelin në krye, data e anëtarësimit ishte shtyrë, së pari në vitin 2020 dhe më pas në 2025-n. Ky proces i zgjerimit është tashmë më i gjatë në historinë e BE-së, pasi zgjati 20 vjet nga fillimi i Samitit të Zagrebit 2000. Politika e kryetarit Makron e bazuar në "thelësinë e reformave para zgjerimit" do ta dobësojë më tutje çdo entuziazëm të vendeve të Ballkanit për anëtarësim në BE.

Pranimi i Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë ka të ngjarë të pengohet me veton e Greqisë, pas fitores së 7 korrikut të partisë konservatore Demokracia e Re atje. Drejtuesi i saj, kryeministri Kyriakos Mitsotakis, kundërshton "Marrëveshjen e Prespës" që i dha fund mosmarrëveshjes disavjeçare me Maqedoninë e Veriut për emrin e saj. Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Dendias, është nga ishulli i Korfuzit, pak larg bregdetit shqiptar dhe pranë rezervave të pasura të naftës dhe gazit në tokë, të cilat janë objekt i një mosmarrëveshjeje territoriale midis dy vendeve.

Ndryshimet e udhëheqësve në institucionet e BE-së do ta ngadalësojnë procesin gjithashtu. Përfaqësuesi i Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Josep Borrell, do ta ndërmytësojë dialogun Kosovë - Serbi edhe pse ai vjen nga Spanja, një vend që nuk e njeh Kosovën. Kushdo që bëhet Komisari i ri i zgjerimit do të luajë gjithashtu një rol vendimtar nëse posti nuk shuhet fare? Sipas këtij skenari, "strategjia e ndërprerjes" e BE-së do të krijonte lodhje integruese në rajon dhe do ta nxiste ndjenjën anti-BE: ëndrra bëhet realitet për fuqitë që kundërshtojnë aleancën euroatlantike. Pasoja më të gjera gjeopolitike të një ndërprerje të gjatë janë të vështira për t'u parashikuar,

duke marrë parasysh se janë të përfshirë tre lojtarë të tjerë: Rusia, Kina dhe Turqia. Sidoqoftë, çdo ndryshim i madh natyrisht nuk ka të ngjarë të ndodhë në planin afatshkurtër dhe afatmesëm. BE-ja do të kalojë gjashtë muajt e ardhshëm duke u përqendruar pas zgjedhimit institucionale pas zgjedhjeve evropiane të verës së kaluar. Duke filluar nga viti i ardhshëm, presidenti Macron do të marrë nga kancelarja gjermane Angela Merkel lidhshmërinë de fakto të Evropës. Në ShBA, në sivjet dhe vitin tjetër do të dominojnë zgjedhjet presidenciale. Në Rusi, mandati i presidentit Vladimir Putin skadon në vitin 2024 dhe në Kinë presidenti Xi Jinping u riemërua nga legjislatura vitin e kaluar dhe nuk e obligon kufizimi i mandateve. Një skenar më pak i mundshëm është ai që BE ta ndryshojë shpejt pozicionin e saj ndaj zgjerimit në Ballkanin Perëndimor. Sipas këtij skenari më optimist, Gjermania dhe Franca do të drejtonin një përpjekje për ta zgjidhur mosmarrëveshjen Kosovë - Serbi brenda dy vjetëve të ardhshëm, duke hapur rrugën për integrimin e rajonit në BE. Gjatë vizitës në Beograd në qershor, presidenti Macron njoftoi se do t'i ftojë në vjeshtë në Paris delegacionet nga Serbia dhe Kosova, si dhe kancelaren Merkel, për të zgjidhur çështjen. Megjithatë, do të ishte surprizë nëse Brukseli do të orientohet drejt një politike më proaktive të zgjerimit. Ky mbetet një skenar i pamundshëm, të paktën për dekadën e ardhshme. Pra, në vend se të udhëheqë një strategji të re për integrimin e Ballkanit Perëndimor në bllok, BE-ja do ta mbajë zgjerimin në pritje, të paktën deri në vitin 2030.

(Botuar në "Geopolitical Intelligence Services". Përktheu nga anglishtja: Arsim Rushit Osmani)

## Filluan punimet në rrugën Budisalc - Zllakuqan

PRISHTINË, 21 GUSHT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën mori pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Budisalc - Zllakuqan i Klinës, investim ky i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Ministri Pal Lekaj i ka premtuar kryetarit Elezi dhe banorëve të Klinës se prioriteti i dikasterit që ai drejton vazhdon të

mbetet zhvillimi i infrastrukturës në fshatra, në mënyrë që të krijohen mundësi më të mira për zhvillim të ekonomive të tyre dhe qarkullim më të lehtë e më të lirë të njerëzve dhe mallrave.

Rruga Budisalc - Zllakuqan është e gjatë mbi 8.6 kilometra, të cilin MIT-ja e financon me 367 mijë euro, në kuadër të memorandumit me Komunën e Klinës.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (22)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin  
NOVOSELLA**

Ajo që na keni lënë ju, Baca Adem është pasuria më e madhe e Kosovës!

Lavdi për jetë e mot, baca Adem!

31 korrik 2018,  
Lirie Gashi

Baca Adem, kolosi i kombit shqiptar dhe njeri që me vepër u bë i pavdekshëm për çdo atdhetar!. Gjatë do jetoj kujtimi për Bacën!

31 korrik 2108,  
Imer Rrahamani

Nuk ka fjalë me të cilën mund të përshkruhet vepra e Bacës Adem! Baca u bë personalitet të cilin e nderoi jo vetëm Kosova por edhe Evropa e bota mbarë! Baca do mbetet përjetësisht në histori! Populli do ta ruaj me krenari kujtimin për Te dhe veprën e tij! Jemi krenari që kishim burra si dy Ademat: Adem Demaçin dhe Adem Jasharin!

31 korrik 2018,  
Fahri Llapashtica

Bacën Adem do ta kujtojmë me epitelin e më të madhit shqiptar të për një shekull. Ai do mbetet atdhetar dhe vepra e tij do nderohet me shekuj!

31 korrik 2018,  
Fadil Dani, Sadik Konjusha, Safet Selimi

Ishte hero dhe do të mbetet hero! Lavdi jetës dhe veprës së bacës Adem! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës që aq shumë e desh!

31 korrik 2018,  
Mehmet Cimili, Mitrovicë

Ishe Skënderbegu im! Na mësove si punohet e luftohet për atdhe! Na mësove si nderohet Kosova! Lavdi të qoftë hero im! Të nderon çdo shqiptar atdhetar!

31 korrik 2018,  
Nurie (mbiemri i palexueshëm)  
USA

Zotëri Adem Demaçi, simbol i rezistencës kombëtare i cili punoi me zell të pashoq për çështjen kombëtare!

31 korrik 2018,  
Lind Bobi

Bacë,  
Edhe sot dhe gjithë jetën për ty e me ty Bacë Adem! Ti na bën nder kudo me veprën tuaj, që nuk plakët kurrë!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

I lehtë të qoftë dheu i tokës arbërore, të cilës i shërbeve deri në frymën e fundit!

31 korrik 2018,  
Tifozët Kuq e Zi, Prishtinë

Në emër të familjes së Zahir Pajazitit, pranoni ngushëllimet më të sinqerta, me rastin e vdekjes së Bacës Adem!

31 korrik 2108,  
Agim Pajaziti

O Baca Adem,  
Hiq pa diskutim, burrë sikur ti me aso virtytsh njerëzore e patriotike, më nuk do të lind në këtë Kosovë, edhe për 500 vjet! Duhet edhe pesë shekuj për të lindur edhe një burrë si ju!  
Me mall e respekt të përkujton familja Thaçi nga Malisheva!

31 korrik 2018,  
Ilaz e Zyhrie Thaçi, Malishevë

Me emrin tënd u frymëzuam të gjithë! Respekt e lavdi!

31 korrik 2018,  
Haki Morina

Respekt dhe lavdi babait të kombit - Bacës Adem Demaçi.

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Rast për të nderuar njeriun tonë i cili na nderoi me vepër! Baca Adem kishte filluar rezistencën në hapat e parë të jetës si djalë i ri! Herët kuptoi se lufta për liri kërkon sakrificë! I përballoi sfida të jetës si rrallë dikush tjetër!

31 korrik 2018,  
Mentor Zymberaj

Respekti për bacën është respekt për lirinë e atdheu! Baca Adem ishte dhe mbeti ideolog i radhëve të para të rezistencës popullore për liri dhe pavarësi të Kosovës! Lavdi për jetë e mot Baca Adem!

31 korrik 29018,  
Ilirijan Zymberaj

Brezi i ri, Bacën e ka pas idhull gjatë gjithë kohës dhe proteste! Ideator i rezistencës paqësore, ishte dhe mbeti deri në fund të jetës. Lavdi i qoftë për jetë e mot!

31 korrik 2018,  
Nexhmedin Kastrati



Lavdi për jetë e mot Bacës Adem Demaçi! Ngushëllime familjes, gjithë bashkëveprimtarëve dhe familjes Demaçi!

31 korrik 2018,  
Emin Ilazi, Vjollca Bajraktari

Mbetesh i paharruar për gjithë atdhetarët dhe për çdo njeri që të ka njohur! Jeta dhe vepra juaj do ketë vend meritore në çdo kohë dhe për shumë mote!

31 korrik 2018,  
Saranda Elshani

Ndarja juaj nga jeta, Baca Adem, ishte lajm i hidhur për ne! Na mbeti ngushëllim vepra jote që nuk vdes kurrë!

31 korrik 2108,  
Ali Shaqiri, Carralevë

Të kemi pasur simbol dhe mbështetje kudo që kemi jetuar! Bëre luftën dhe qëndrove si i ka hije një atdhetari! Ardhja jonë këtu ka qellim nderimin Tuaj të përjetshëm!

31 korrik 2018,  
Vildane Sadiku, Preshevë

Bacë, ti nuk ke vdekur! Ti jeton me ne, jeton në mendjet dhe zemrat tona deri sa të ketë jetë!

31 korrik 2018,  
Halide Vinca

Në këtë ditë të nderimit për ty, baca Adem, të themi se sa të ketë se do të nderojmë sa të ketë diell, përgjithmonë do jeni i gjallë me veprën tuaj. Vlerat tuaja nuk vdesin asnjëherë dhe ato do të kultivohen brez pas brezi në çdo pjesë të atdheut!

31 korri 2018,  
Hamdi Aliu, Rezallë; Fadil Quni, Mazgit; dhe Idriz Fazliu, Drenas

I shenjtë Bacë,  
Pema të cilën e mbolle para 50 vjetësh do jep fryte përjetësisht dhe nuk do të thahet kurrë! Lavdinë ia thure veti për së gjalli me vepër!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi mungon)

Lamtumirë o Skënderbe i kohës sonë! E kemi vështirë të ndahe mi! Ti na dhe atë që pak kush mund ta paramendonte! Yjet si ti nuk shuhën kurrë dhe rrezatojnë me mijëra vjet! I pavdekshëm mbetesh Baca Adem!

31 korrik 2018,  
Ibrahim Muça

Pusho i qetë, hero i ynë!

30 korrik 2018,  
Faton Z.

Heroi ynë i pavdekshëm, Baca Adem Demaçi! Pusho i qetë në tokën tënde të cilën e deshe aq shumë!

31 korrik 2018,  
E. Selimi

Heroi i pavdekshëm! Pusho në paqe!

31 korrik 2018,  
Sh. Nushi

Lavdi burrështetasit të Kosovës, Bacës Adem Demaçi!

31 korrik 2018,  
Qerim Koka

I paharruar qoftë kujtimi për ty, simboli i qëndresës shqiptare kundër shtypjes! Lavdi të qoftë për jetë e mot!

31 korrik 2018,  
Feriz Xhema

Mbetesh i pavdekshëm, hero i ynë, Baca Adem!

31 korrik 2018,  
Enver Shulemaja, Ibrahim Tafolli, Ferizaj, KMLDNJ

Bëre një jetë luftë për liri dhe pavarësi të popullit tonë! Çdo respekt për jetën dhe veprën tënde, Baca Adem!

31 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

Jam krenar që bashkëjetova me dy kolosët e kombit shqiptar; Legjendarin Adem Jasharin dhe Bacën, Adem Demaçin!  
Me respekt të përjetshëm!

Salih Salihu, invalid i luftës së UÇK-së me djalin Dritonin, dhe me nipin Dardanin.

31 korrik 2018,  
Sali Salihu  
Dervar, Vushtrri

Nderim të përjetshëm për Bacën Adem Demaçi! Legjendat nuk vdesin! Ti ke mbetur legjendë, Bacë!

31 korrik 2018,  
Bardhyl Stallova

Jam krenar që e linda e jetoj në Epokën e tij, sepse gjersa veprime dëshmove çfarë ishe, Bacë! Adem Demaçi, as për mua, as për popullin shqiptar nuk vdes kurrë! Çfarëdo historie që nuk e ka emrin e tij, s'mund të quhet histori! Ademi kishte vizion që rrallë kush e ka në kombin tonë! Ishte diell kombëtar, që rrezon, dhe i tillë mbetet sa të ketë njerëz e diell!

31 korrik 2018,  
Rrahim M. Sadiku

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

E rrallë

## Peru, gjendet një moral 3 800-vjeçar i një qytetërimi të zhdukur

Një murale që mendohet të jetë 3 800 vjeçare është zbuluar nga arkeologët në Peru. Muri, i zbuluar të hënën, u gjet brenda një ndërtese ceremoniale publike në Vichama, në veri të Limas. Skena e gdhendur komplekse përshkruan ikonografinë duke përfshirë një toadë të ngjashme me njeriun dhe përfaqësime të njerëzve. Dr. Ruth Shady Solís, drejtori i Zonës



Arkeologjike të Caral (ZAC), beson se skena përfaqëson "ardhjen e ujit" përmes reshjeve të shiut. Pritet që ky zbulim të bëhet një nga preferencat e ardhshme turistike.

FOTO E DITES



Një breshkë gjigante shihet në parkun natyror "La Vanille në Riviere des Anguilles" në Mauritius. /Reuters/

E jashtëzakonshme

## E moshuara lë trashëgimi 200 000 euro për 69 familje me fëmijë me aftësi të kufizuara

Olga Ghirardi, një grua e moshuar nga Pinerolo, afër Torinos, shprehu një dëshirë të fundit para se të vdiste: T'u linte një pjesë të trashëgimisë së saj familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara. Në testamentin e saj, Olga tha se dëshiron të dhuronte 200 000 euro komunës, në mënyrë që t'i shpërndajë ato tek më nevojtarët. Një gjest që



befasoi qytetarët, të cilët më 16 shtator do të organizojnë një ceremoni publike për nder të saj. Kështu, komuna ka vendosur të publikojë një thirrje për t'i zgjedhur familjet të cilave do t'u caktohet trashëgimia e Olgës. Deri tani kanë mbërritur 75 kërkesa, por nga këto vetëm 69 janë pranuar.

## BARSOLETA E DITËS



Telefonon një bionde në polici: Më kanë hyrë hajnat në makinë, m'i kanë vjedhur të gjitha, timonin, pedalet dhe ndërrimin e shpejtësive. Pas pesë minutash merr përsëri policinë dhe i thotë: Ju kërkoj ndjesë, po kisha hipur në vendin prapa.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min  
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



#### Në ora 17:30

### GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




#### Çdo ditë në ora 19:15

### "HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.  
Regjia: David Leitch



### Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

 <p><b>DASHI</b> Sot do të gjendeni përballë një problemi që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk duhet ta lini pas dore.</p>	 <p><b>DEMI</b> Dikush po përpiqet t'ju hapë sytë dhe t'ju tregojë atë që duhet të bëni. Mundohuni ta ruani intimitetin brenda dyerve të shtëpisë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot vini në plan ta parë zemrën tuaj dhe veproni siç ju thotë ajo. Mos merrni për bazë paragjykimet e të tjerëve.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot duhet t'i tregoni partnerit që do t'i gjendeni gjithmonë pranë, edhe në ato çaste që duket sikur jeni larguar.</p>	 <p><b>LUANI</b> Një marrëdhënie e caktuar mund të shkojë shumë më mirë nga sa e mendoni, nëse ju u lini hapësirë personave të tjerë t'ju gjenden pranë.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Duhet të jeni pak më të ashpër me persona të caktuar sepse ju kanë vënë përballë problemesh që do t'ju rëndojnë shumë sot.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Do të kujtohemi në çast të fundit për një porosi që ju kanë lënë. Harresa juaj do të bëjë që një miqësi e vjetër të lëkundet.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Nëse ende nuk e keni kuptuar se çfarë duhet të bëni, mbase është mirë që të kërkonit ndihmë të personat që keni pranë.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot jeni të bindur që po veproni mirë lidhur me një çështje të caktuar. Koha do të tregojë nëse keni pasur vërtet të drejtë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Është mirë që të filloni të merrni më seriozisht anën emocionale tuajën. Kjo ju ndikon në gjithçka që do të bëni më vonë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Vini në punë intuitën tuaj dhe zgjidhni mënyrën dhe rrugën më të thjeshtë për të dalë në përfundim të një situatë që ka ngecur prej kohësh.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Shumë herë me atë që thoni dhe bëni i çoni njerëzit të mendojnë ndryshe për ju. Kjo gjë ju intrigon dhe e bëni herë pas here.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Osmani harron humbjen nga 'Nikli': Duam pikë ndaj Llapit

Përparim Osmani beson shumë se Drenica do t'u kthehet rezultateve pozitive në ndeshjen ndaj Llapit e cila zhvillohet të premten në Skenderaj. "Ne e dimë se ndaj Llapit nuk do të jetë aspak lehtë, sepse ka skuadër mjaft cilësore. Megjithatë, jemi përgatitur që të paraqitemi sa më mirë dhe t'i shijojmë pikët e para në këtë edicion dhe, po ashtu, t'i kënaqim shikuesit tanë", ka thënë Osmani

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 GUSHT - KF Drenica është përgatitur që ta harrojë humbjen e thellë nga Feronikeli (4-1), në ndeshjen e dytë të IPKO Superligës ndaj Llapit. Ndeshja në mes të kuqezinjve dhe djelmoshave të Tahir Batatinës është ndeshja e parë e javës së dytë dhe zhvillohet të premten të stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj.

Mbrojtësi Përparim Osmani, që iu bashkua skuadrës së Drenicës në afatin kalimtar të verës, ka thënë se ndeshja e radhës do të jetë e vështirë, por që përgatitjet janë bërë që të shijohen pikët e para në këtë kampionat dhe të gëzohen tifozët. "Ne e dimë se ndaj Llapit nuk do të jetë aspak lehtë, sepse kanë një skuadër mjaft cilësore. Megjithatë, jemi përgatitur mirë që të paraqitemi sa më mirë dhe t'i shijojmë pikët e para në këtë edicion, po ashtu t'i kënaqim edhe shikuesit tanë", ka thënë Osmani, duke lënë të nënkuptohet se rezultati në ndeshjen e parë ndaj kampionëve të Feronikelit nuk ka qenë real.

Futbollisti i krahut të djathtë në pjesën e dytë të edicionit të kaluar ishte i huazuar nga Prishtina te Drita ku zhvilloi mjaft paraqitje të mira, por nuk i bindi drejtuesit e skuadrës së Prishtinës për ta mbajtur në skuadër për faktin se në pozicionin e njëjtë luan edhe Armend Thaqi. Kjo e detyroi Osmanin të transferohet në Drenicë dhe është i paraqitur me aventurën e gjertanishëm në këtë klub. "Deri me tash gjerat janë duke shkuar mirë dhe besoj se edhe në të ardhmen asgjë nuk do të ndryshojë. Jam mirë i përgatitur fizikisht dhe dua ta ndihmoj klubin sa më shumë për arritjen e objektivave", ka deklaruar Osmani, i cili ka bërë karrierë edhe në skuadrën e Feronikelit, Hysit dhe Ulpianës. Skuadra që drejtohet nga Tahir Lushtaku në afatin kalimtar bëri disa ndryshime ku, përveç Osmanit, transferoi edhe Drin Hodajn, Hasan Hysenin, Genc Hamitin, Argjent Mustafën dhe Vilfor Hysën.



Të premten fillon edhe Liga e Parë

Pas IPKO Superligës së Kosovës në futboll, nesër (e premte) fillon edhe Liga e Parë. Ndeshja hapëse në këtë rang garash zhvillohet në mes të Malishevës dhe KEK-ut. Skuadra e Malishevës u inkuadrue nga Liga e Dytë, kurse KEK-u ka rënë nga elita. Të shtunën zhvillohet ndeshja në mes të Ramiz Sadikut dhe Dardanës. Skuadra nga kryeqyteti e siguroi mbetjen në Ligën e Parë nëpërmjet barazhit, kurse skuadra nga Kamenica u inkuadrue po nëpërmjet barazhit. Tri herë kampionia e Kosovës, Besa, të dielën në Pejë luan ndaj Vllaznisë së

Pozharanit, kurse Vëllaznimi është mysafir i Onixit.

### LIGA E PARË

**TË PREMTEN TAKOHEN:**  
17:00 Malisheva - KEK-u  
Të shtunën takohen:  
17:00 Ramiz Sadiku - Dardana

**TË DIELËN TAKOHEN:**  
17:00 2 Korriku - Vitia  
17:00 Onix - Vëllaznimi  
17:00 Drenasi - Arbëria  
17:00 Ulpiana - Istogu  
17:00 Besa - Vllaznia  
17:00 Trepça - Liria

### SHKURT

#### Drita prezanton Cuculin

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka prezantuar transferimin e ri, Ardian Cuculin. Mbrojtësi Cuculi u largua nga skuadra e Kukësit dhe vendosi që karrierën ta vazhdojë në skuadrën nga Gjilani. 32-vjeçari ka bërë karrierë edhe në këto skuadra: Shkëndijë, Partizan të Tiranës, Milano, Pobeda dhe Vëllazërim 77.

#### Xhaka rikthehet kundër Liverpoolit

Kapiteni i Arsenalit, Granit Xhaka është rikthyer për ndeshjen derbi të Premierligës kundër Liverpoolit, pasi mungoi javën e kaluar kundër Burnley shkaku i lëndimit. "Jam rikthyer.. po ndihem mirë", ka shkruar Xhaka në "Facebook".

#### Volejbollistet e Kosovës U17 pësojnë humbje nga Greqia

Përfaqësuesja e Kosovës në volejboll ka pësuar humbje në ndeshjen e parë të Kampionatit Ballkanik U17. Vashat e Kosovës janë mundur nga Greqia me rezultat 3-0 (13:25, 9:25, 18:25). Ndeshja e radhës për vashat e Kosovës do të jetë ndaj Turqisë. Kujtojmë se Kampionati Ballkanik në volejboll për femra U17 po mbahet në Lukavac të Bosnje Hercegovinës.

#### Lugano huazon Kryezin te Chiasso

Ish-sulmuesi i Dritës nga Gjilani, Leotrim Kryeziu, karrierën futbollistike do ta vazhdojë në skuadrën e Chiassos. Ai është huazuar nga Lugano për një edicion derisa këtë lajm e ka konfirmuar vetë sulmuesi në fjalë. "Edhe zyrtarisht e kam mbyllur transferimin tim te klubi i Chiasso (Challenge League) si huazim njëvjeçar nga klubi im Lugano. Me këtë në radhë të parë dua ta falënderoj klubin e Luganos për këtë mundësi, gjithë ata që më mbështeten dhe mundësuan kalimin tim te Chiasso, gjithashtu edhe klubin tim të ri Chiasso për besimin e dhënë. Shpresoj dhe besoj se do ta ndihmoj klubin me kontributin time që të ngjitemi sa më lart në Challenge League", ka thënë Kryeziu.

## Khalidi ndahet me Prishtinën, shkon te Teuta

PRISHTINË, 21 GUSHT - FC Prishtina ka njoftuar se Basid Abdul Khalid është larguar edhe zyrtarisht nga klubi pas plotë tre vjetësh. Sulmuesi nga Gana karrierën do ta vazhdojë në futbollin shqiptar, përkatësisht

në skuadrën e Teutës. "Sulmuesi 23-vjeçar i ardhur në Prishtinë më 2016 nga FC Stars nga Gana, pas 3 vjet me fanellën e Prishtinës me 105 paraqitje, 30 gola të shënuar dhe 11 asistime, ndahet me Prishtinën dhe tani e

tutje e vazhdon karrierën me Teutën e Durrësit", thuhet në njoftimin e klubit më të madh në Kosovë. FC Prishtina e falënderoi Khalidin për mundin e dhënë për klubin dhe i ka uruar sukses në vazhdim të karrierës.



## Curry: Kemi fituar edhe pa Durantin

OAKLAND, 21 GUSHT - Stephen Curry beson se skuadra e Golden States do të dijë si të jetë sërish protagoniste sezonin e ri në NBA, pavarësisht largimit të Kevin Durantit. "Jemi entuziastë

për faktin se lojtarë të rinj kanë ardhur në ekipin tonë këtë sezon. Ata do të kenë një mundësi të artë pranë nesh për t'i treguar vlerat e tyre. Madje ata mund ta bëjnë dallimin në fushë. Ne e

dimë se si fitohet, kemi gati pesë vjet që jemi në elitën e NBA-së. Thjesht këtë gjë do ta bëjmë në një mënyrë tjetër", ka thënë Curry. "Durant? Tani luan në një ekip tjetër. Është një kampi-

on i madh, na ka ndihmuar shumë dhe i uroj shërim të shpejtë. Pavarësisht se ai u largua, ne do të fitojmë pasi këtë gjë e kemi bërë edhe para se të vinte ai", ka shtuar Curry.



## Shkenca e vlerëson Messin më të mirin

BRUKSEL, 21 GUSHT - Pyetja se cili prej atyre të dyve është më i mirë, ende mbetet një mister. Lojtarë të ndryshëm, por të dy yje që do të mbeten gjatë në historinë e futbollit. Por, është shkenca që përpikë t'i japë një përgjigje kësaj dileme, se cili prej Lionel Messit, apo Cristiano Ronaldos, është më i mirë në sportin më popullor në botë. Sipas një studimi të publikuar nga "Universiteti Katolik i Lyvenit" në Belgjikë, bashkë me kompaninë holandeze të specializuar në statistikat dhe të dhënat sportive, "SciSports", thuhet se futbollisti më i fortë është Messi. Studimi, në fakt, nuk prek vetëm golat apo asistimet gjatë një ndeshjeje, por bazohet në një parametër të quajtur VAEP (Vlerësimi i Veprimeve në fushë përmes Vlerësimit të Mundësive). E thënë më thjesht, në studim janë marrë të gjitha ndeshjet nga sezoni 2013-14, deri në 2017-18, ku janë mbikëqyrur goditjet, pasimet, driblimet, apo çdo gjë që bën një lojtar në fushë e lojës, që sjell ndikim tek rezultati final, si në sulm, ashtu edhe në fazën mbrojtëse. Sipas këtij parametri, vlerësimi për Messin



është 1.21 VAEP, ndërsa Ronaldo mbetet shumë larg, në kuotën 0.61. Studimi shprehet se vlerat e Messit dhe Ronaldos ishin pothuajse të ngjashme në sezonet e para kur nisi edhe matja, por në sezonin 2015-16,

"Pleshti" pati një rritje kundrejt rivalit të tij të përjetshëm. Argentinasi, sipas këtij studimi, ka një ndikim më të madh se Ronaldo jo vetëm të zona e portës kundërshtare, por mbi gjithë skuadrën.

## Federeri: Tenistët e rinj nuk do ta kenë kurrë talentin tonë



CYRIH, 21 GUSHT - Në prag të grand slam US Open-it që nis javën e ardhshme, tenisti zviceran Roger Federer ka folur edhe një herë për të ardhmen e vet. Numri 3 në botë u shpreh se për sa kohë ai arrin të jetë fitues do të vazhdojë të luajë. "Mendoj se askush nuk e kishte menduar që unë, Djokoviq dhe Nadal, do të dominonim kaq gjatë

këtë sport. U bënë vite që ne po fitojmë thujse të gjithë turnetë e rëndësishëm dhe kjo e ka një arsye", ka thënë Federeri. "Ne kemi qenë konstantë dhe solidë me kalimin e viteve. Ne kemi ndaluar shpërthimin dhe rritjen e shumë të rinjve premtues. Ndaj nuk jam i sigurt se shumë të rinj sot do ta kenë talentin tonë në të ardhmen. Të

hysh në 'top-8' është e vështirë, të qëndrosh aty edhe më e vështirë. Imagjino që këta të rinj të jenë gjithnjë mes 3 më të mirëve në botë apo të luajnë deri në moshën 40-vjeçare. Unë shpresoj, por nuk shoh shumë shpresa te këta të rinj. Unë, për sa kohë argëtohem dhe fitoj, do të vazhdoj të luaj pa probleme", ka deklaruar Federeri.

### SHKURT

#### Ribery, lojtar i Fiorentinës

